VENDIM
Nr.429, datë 20.10.1997

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË GREQISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrit të Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e protokollit të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës të Greqisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, i cili i bashkëngjitet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministri i Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik që, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe ministritë përkatëse:

a) të përgatisin projektet që do të financohen në kuadrin e protokollit të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve;

b) të përgatisin dhe negociojnë me palën greke për kushtet, skemat financiare, detajet teknike dhe marrëveshjet përfundimtare të projekteve e të kredive që do të nënshkruhen ndërmjet dy palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

PROTOKOLL
MBI BASHKËPUNIMIN EKONOMIK NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË GREQISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË

Qeveritë e Republikës së Greqisë dhe Republikës së Shqipërisë,

Duke marrë në konsideratë:

a. Gatishmërinë dhe angazhimin e Qeverisë greke për të mbështetur Qeverinë shqiptare për të kaluar situatën e tanishme ekonomike;

b. Programin koherent të një kredie të butë prej 20 bilionë dhrami greke (GDR) në mbështetje të ekonomisë shqiptare, i cili u përgatit në përputhje me propozimet e Qeverisë shqiptare, dhe

c. Shumën prej 2 bilionë GDR, brenda kuadrit koherent të sipërpërmendur të mbështetjes ekonomike prej 20 bilionë GDR, tashmë të dhënë nga Greqia gjatë vizitës së Ministrit të Punëve të Jashtme, z.Paskal Milo në Athinë në 12 shtator 1997,

ranë dakord për sa më poshtë vijon:

1. Qeveria greke do t'i japë Qeverisë shqiptare një kredi prej 3 bilionë GDR, me qëllim përballimin e problemeve të karakterit makroekonomik dhe në mënyrë specifike për mbështetjen e bilancit të pagesave. Kredia do të kanalizohet nëpërmjet bankave qendrore të të dy vendeve. Emërtimi i monedhës është GDR dhe kushtet e kredisë janë si vijon:

Maturia	20 vjet
Përqindja e interesit	4%
Pagimi i interesit	me këste 6-mujore
Pagimi i principalit	në datën e maturimit

Ministria e Ekonomisë Kombëtare të Greqisë dhe Ministri i Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik të Shqipërisë, në bashkëpunim me bankat qendrore të të dy vendeve do të përgatisin detajimet e marrëveshjes së kredisë, në emër të qeverive respektive.

2. Pjesa e mbetur prej 15 bilionë GDR do të alokohet si vijon:

a) 5 bilionë GDR për programet e infrastrukturës sociale;

b) 5 bilionë GDR për programet për ndërtime shtëpish;

c) 5 bilionë GDR për mbështetjen e sektorit privat, me prioritet atyre ndërmarrjeve të interesuara greke, shqiptaro-greke, dhe shqiptare, të cilat u dëmtuan gjatë trazirave të fundit në Shqipëri dhe që dëshirojnë të vazhdojnë aktivitetin dhe punën e tyre në Shqipëri.

Kushtet e kësaj pakete prej 15 bilionë GDR janë si vijon:

Maturia	25 vjet
Përqindja e interesit	5%
Periudha mospagimit	7 vjet
Pagimi i interesit	me këste 6-mujore
Pagimi i principalit	me këste 6-mujore

Seleksionimi i projekteve që do të financohen në kuadrin e programeve të sipërpërmendura do të vendoset nga të dyja palët, bazuar në propozimet konkrete që do të paraqiten nga pala shqiptare. Propozimet për projekte do të përfshijnë objektivat e projekteve, parametrat e shpenzimeve dhe grafiku kohor i zbatimit.

Pagimi i kredisë do të bëhet nëpërmjet një mekanizmi zbatimi, i cili miratohet nga Ministria e Ekonomisë Kombëtare të Greqisë dhe autoritetet kompetente shqiptare.

Elementet e këtij protokolli mund të jenë propozimi grek në Konferencën e Donatorëve, në 22 tetor, në Bruksel.

Nënshkruar në Tiranë, më 15 tetor 1997, në dy kopje në gjuhën angleze.

Znj.Ermelinda Meksi	Mr. Alexandros Baltas
Ministër Shteti për Zhvillimin	Zëvendësministër i Ekonomisë
dhe Bashkëpunimit Ekonomik të Shqipërisë	Kombëtare të Greqisë